



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 7
Prishtinë, më 31. 3. 2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: z.Enver Hoxhaj, znj.Teuta Rugova, z.Cerim Bajrami, znj. Blerta Deliu-Kodra, z. Elmi Reçica, z.Ismet Beqiri, znj.Puhie Demaku, z. Ramush Haradinaj dhe z. Zafir Berisha.

Delegacioni i Grupit të Miqësisë i Asamblesë Nacionale të Francës: Znj. Geneviève Gosselin-Fleury, kryetare e Grupit të Miqësisë Kosovë - Francë, z. Francis Hillmeyer, nënkryetar, z. René Rouquet, anëtar, z. Pierre-Yves Le Borgn anëtar, z. Thierry Beaugendre, sekretar, znj. Roxane Baux, atashe parlamentare e kryesueses dhe ambasadorja e Francës në Kosovë, znj. Maryse Daviet dhe z. Lulzim Hiseni, ministër- këshilltarë i Republikës së Kosovës.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati-ZPRK.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

Takim i Komisionit me Grupin e Miqësisë të Asamblesë Nacionale të Francës

Enver Hoxhaj delegacionit të Grupit të Miqësisë së Francës, i dëshiroi mirëseardhje në Kosovë, duke shtuar se këtë takim e konsideron shumë të rëndësishëm dhe një nismë të re të grupeve të miqësisë. Hoxhaj falënderoi për mbështetjen që i ka dhënë Franca shtetit të Kosovës, në rrafshin bilateral si vend mbështetës i pavarësisë së Kosovës.

Kontributi i Francës, tha ai, ka qenë shumë i rëndësishëm sa i përket negociatave për MSA-në, marrjes së udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave e po ashtu për anëtarësimin e Kosovës në Komisionin e Venedikut dhe Bankën Zhvillimore.

Geneviève Gosselin- Fleury, kryetare e Grupit të Miqësisë Kosovë - Francë, shprehu kënaqësinë për formimin e grupit të miqësisë në mes të Kosovës dhe Francës në këtë legjislaturë, në mënyrë që të shkëmbehet bashkëpunimi në mes të dy vendeve.

Ramush Haradinaj në diskutimin e tij, ndër të tjera falënderoi Francën për mbështetjen e vazhdueshme që ka bërë për Kosovën. Kosova tha ai, ka ende sfida dhe i duhet edhe mëj mbështetja e Francës, e sidomos sa i përket anëtarësimit në organizata ndërkombëtare dhe njohjes së pavarësisë së saj.

Puhie Demaku theksoi se Franca është një partner strategjik për Kosovën dhe se ndihma e saj është e nevojshme edhe për vitet në vijim. Ajo tha se Kosovën e presin sfida të shumta, e mes tyre ceku anëtarësimi në Këshillin e Evropës, liberalizimin i vizave dhe në përgjithësi integrimi në BE. Në Kuvend, ka njerëz të cilët janë të përkushtuar që të punojnë për ta ndryshuar gjendjen përbrenda, e cila do të reflektonte edhe në marrëdhëniet me jashtë, tha Demaku.

Cerim Bajrami njoftoi delegacionin se ai e përfaqëson komunitetin boshnjak, në GP6+, i cili është i përbërë nga deputetë të komunitetit turk, boshnjak, rom dhe ashkalinj. Bajrami falënderoi Francën për ndihmën e vazhdueshme që i ka dhënë Kosovës, duke shtuar se Franca është një shtet i fuqishëm dhe presin mbështetje për Kosovën edhe në të ardhmen në procesin e integrimit evropian.

Zafir Berisha theksoi se jemi mirënjohës për kontributin që ka dhënë Franca në ndërtimin e shtetit të Kosovës, duke filluar nga ndihma ushtarake e deri te ndihma diplomatike e politike, që po ndodh deri më tani. Kosova tha Berisha, gjeografikisht është pjesë e Evropës, por për fat të keq ende nuk është pjesë e familjes evropiane, dhe në këtë drejtim shpreson që nuk do të mungojë ndihma e Francës, që sa më shpejt Kosova e Ballkani të jenë pjesë e familjes evropiane.

Geneviève Gosselin- Fleury falënderoi deputetët për besimin e shprehur, duke theksuar se pas takimit me Grupin e miqësisë, do të punojnë për identifikimin e pikave të bashkëpunimit në mes tyre.

Enver Hoxhaj falënderoi delegacionin për bashkëpunimin dhe ambasadoren franceze për mbështetjen që i ofron Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Enver Hoxhaj